



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 315/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Blerim Dina–Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Vlera” SH.P.K. kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Besim A. Zejnullahu B.I. - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dizinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore” me nr. prokurimit: 616-191655-2-2-1, -të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 22.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Vlera” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dizinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore” me nr. prokurimit: 616-191655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Dizinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore” me nr. prokurimit: 616-191655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Vlera” SH.P.K, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë: 05.04.2019: Lloji i procedurës së aplikuar: Kontrate kornizë 12 muaj, Procedurë e hapur. Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Shërbime. Vlera e parashikuar e kontratës: 25,000.00 €. Kriteri për dhënie të kontratës (N.52) Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 25.04.2019. Data e hapjes së ofertave: 25.04.2019. Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave 27.05.2019. Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm: 31.05.2019. Data e njoftimit mbi Vendimin e AK - B58 31.05.2019. Data e kërkesës për rishqyrtim: 03.06.2019. Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 06.06.2019.

Operatori ekonomik ankues "Vlera" SH.P.K. si palë e pa kënaqur ka deponuar ankese në OSHP me date: 14.06.2019 me nr. 315/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Besim A. Zejnullahu B.I. - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dizinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore" me nr. prokurimit: 616-191655-2-2-1, duke pretenduar në shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së:

- Neni 1: Qëllimi.
- Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.
- Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.
- Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
- Neni 69: Aftësia teknike dhe profesionale.
- Neni 60: Kriteri për dhënie të kontratës. Dispozitat e vendimit të PSH nr. 61, 62 dhe 65/19 të datës: 27.03.2019

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e datës: 26.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, dhe 60 të LPP-së.

Duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e qe ne rastin konkret OE ankuese, këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, eksperti shqyrtues bazuar ne nenin 109 të LPP-së si dhe paragrafit 9.2 të nenit 9 te dokumentit F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2, ku thuhet: "Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues" si dhe neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2017, në të cilën thuhet: "Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues", andaj nga të cekurat si më lartë pretendimet në fjale nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 59 dhe 69 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" sepse operatori ekonomik ankues ka ngritur përmes platformës elektronike e-prokurim dokumente si ne vijim:

Grupi i OE ankues "Vlera" Sh.p.k. ne platformën elektronike e-prokurim, ka paraqitur listën e stafit me një ekip prej 14 anëtar – ekspert (ne këtë liste mungon data), bashkangjitur janë diplomat, CV, Kontratata, (mirëpo për z. EkremSogojeva - Mjek Specialist i Epidemiologjisë– ka sjelle: Certifikatë nr.210 date 08.07.1987, Enti Krahinore për Mbrojtjen Shëndetësore – Prishtinë, Kontrata, por i mungon CV-ja), listën e kontratave ne tri vitet e fundit nga njoftimi për kontrate ne vlerë totale: 30,927.95 €, ndërsa OE "EkoDezDoo" ka paraqitur një Listë te Stafit me një ekipi prej 20 ekspert te licencuar DDD, Vërtetim nga Instituti i Epidemiologjisë ne Akademinë Ushtarake, sektori për spitalet parandalues (ne këtë liste mungon data, mungon diplomat dhe CV), listën e kontratave te realizuar ne tri vitet e fundit me numër rendor 10 kontrata te përfunduar ne vlere rreth: 344,399.00 €, (kontratata dhe referencat janë ne gjuhen serbe dhe janë

ne valutën Dinarë), Gjithashtu, Grupi i OE ankues ne këtë aktivitet te prokurimit nëparamasen – përshkrimin e çmimeve ka ofertuar me çmimin për njësi me TVSH prej: 0.037 €. Prandaj, duke u bazuar nga te gjitha këto dokumente konsideroj se është e pandershme nga ana e komisionit te vlerësimit ashtu edhe nga departamenti i prokurimit tek Letra standarde për tenderuesin e eliminuar te jap ARSYTIM ti shkruaj operatorit ekonomik se nuk keni plotësuar kërkesën 1 (nuk keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesional duke shkruar komplet kërkesën dhe dëshmitë nga FTD-ja – pa dhënë një sqarim konkret dhe bindes duke arsyetuar përmes bazës ligjore), kurse ne VENDIMIN te datës 06.06.2019 te kërkesa për rishqyrtim, ZPP tek arsyetimi po citoj: “OE është i papërgjegjshëm sa i përket dokumentacionit te ofruar për me tepër gjatë ekzaminimit te ofertës se tij me rastin e rishqyrtimit te kësaj kërkesë kemi hasur ne një lëshim tjetër të bërë nga OE në Konsurcium, ai ka shkelur nenin nenin 18.3 te Rregullores se udhëzuesit te prokurimit publik“ andaj bazuar nga i gjithë ky sqarim, konsideroj se ne këtë aktivitet i prokurimit nuk janë respektuar ne tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu, duke marr për baze kërkesën nga AK nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se, po citoj: Kërkesa: OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: - Një (1) epidemiolog te diplomuar - Një(1) teknik sanitar; Dëshmia: Duhet dorëzuar si dëshmi: kopjet e diplomave, CV dhe kontrata e punës (marrëveshja për angazhim).

Kërkesa: 1. OE-ik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në 36 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlere prej 50,000 euro.

Dëshmia 1: Lista e projekteve të realizuara të dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave të pranimeve në 3 vitet e fundit duke saktësuar - punët e përfshira, - shumën e kontratës, - datën dhe pranuesin

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i rivlerësimit ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 39 të RrUOPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuar në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankesa e OE: "Vlera" Sh.p.k. – Shtime, për tenderin e AK: Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore", me nr. prokurimi: 615-19-1416-5-2-1, lidhur me njoftimin për kontratë, rekomandon që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuara, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin 2 si më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë brenda afatit ligjor nuk ka kthyer përgjigje me shkrim për ta njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet a po jo me raportin e ekspertit shqyrtues profesional.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së "Vlera" SH.P.K. " z. Salihaj deklaroi: Ne pika të shkurtra do të ju njoftoj për shume pa rregullsitë në këtë AP procesi i hapjes ka qenë me datë 25.04.2019, njoftimi është bërë me 29.05.2019, 34 dite me vonese nga momenti që ka tejkaluar afatin normal për pos në raste të veçanta dhe konsideroj që ky AP nuk ka qenë rast i veçantë. Pas njoftimit në kemi bërë ankesën njoftimi ka qenë Grupi i OE "Vlera" SH.P.K. nuk ka plotësuar kërkesën OE duhet të ofroj shërbimet të mjaftueshme të ngjashme që ka realizuar punë të tilla në 36 muajt e fundit në vlerë prej 50.000 euro dhe arsyeja tjetër nuk kemi plotësuar si duhet kërkesën për stafin profesional. Në afatin ligjor kemi bërë ankesën dhe ju kemi ritreguar kopjet prej 104 faqeve vetëm për stafin profesional, në ankesë jemi fokusuar vetëm në 2 pikat edhe pse eksperti i OSHP-se ka konstatuar shkelje edhe në 6 shkelje të tjera.

Neve na kanë eliminuar për 2 arsye: 1. QE nuk ke qarkullim prej 50.000 euro dhe 2. Nuk keni staf profesional.

Në konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59 duke mos e vlerësuar ofertën drejtë si dhe nenin 69 duke e hedhur poshtë aftësitë teknike dhe profesionale të kompanisë, ta cekim se kërkesa e AK si pas kushteve të tenderit ka qenë: që OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të

ngjashme ne 36 muajt e fundit ne vlere prej 50.000 euro, dëshmia qe kemi ofruar: është ofruar lista e projekteve te dëshmuara me kopje te referencave certifikatave dhe faturave ku totali i qarkullimit për 36 muaj dëshmohe se është 605.608.84 euro, lista e kontratave ka qenë e kompletuar me referencat dhe ekstraktet bankare, vërejtje tjetër ku këta kanë konsideruar qe ne nuk kemi staf të mjaftueshëm dhe ne listën ku është neni 69 ku kërkohen vetëm 2 punëtorë 1 Epidemiolog dhe një teknik sanitar kështu është kërkuar, kurse ne dokumentacionin tone kemi ofruar listën me 12 te punësuar edhe pse kërkesa e Autoriteti Kontraktues ka qen 2. Ne kemi EkremSokojeva është Epidemiolog i Diplomuar teknik sanitar kemi 10. Ne kërkesën qe kemi bërë për rishqyrtim këta kanë refuzuar ta bëjnë rivlerësimin ku për mendimin tim është absurditet ku te kesh staf prej 12 punëtor dhe te kërkosh 2 te kesh qarkullim prej 600 mije euro e sipër dhe te mos pranosh te besh rivlerësim është një ofendim për se cilën do pale. Te gjitha vërejtjet qe ka dhen eksperti përputhën me vërejtjet tona dhe ka vërtetuar qe lista e punëtorëve qe ne kemi paraqit 12 është 14.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Sekiraqa deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet aspak me mendimin e ekspertit konsideroj se vlerësimi i ofertave është ber konform LPP-së. Oferta e OE ankues ka pasur shumë mangësi nder te tjerash pas vlerësimit pas pranimi te kërkesës për rishqyrtim kemi hasur me një çmim për njësi me 3 numra pas pikës dhjetore, ne dosje nuk e kemi cekur qe lejohet me shume se 2 numra pas presës dhjetore dhënia e këtij çmimi automatikisht e eliminon automatikisht OE nga kjo procedure, këtë mund te shohim tek pika 18.3 e Udhëzuesit te prokurimit publik.

Konsiderojmë se komisioni i ka llogaritur mire vlerën e referencave dhe dëshmitë për stafin profesional ku nuk i ka plotësuar disa kërkesa.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues profesional z. Beqiri deklaroj: Qëndroj prapa raportit te dhenë në ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lëndën ta kthen në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkojmë qe të hedhet poshtë ankesa e OE dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja eAK-së znj. Isufideklaroj:te mos e pranoj mendimin e ekspertit por te vendos për vendimin e komisionit për rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit te palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankuesi pretendon se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, dhe 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e që në rastin konkret OE ankuese, këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, eksperti shqyrtues bazuar në nenin 109 të LPP-së si dhe paragrafit 9.2 të nenit 9 të dokumentit F03 Rregullat për parashtrim të ankesave-verzioni 2, ku thuhet: "Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues" si dhe neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2017, në të cilën thuhet: "Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nënë e caktuara të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues", andaj nga të cekurat si më lartë pretendimet në fjale nuk janë trajtuar .

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 59 dhe 69 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" sepse operatori ekonomik ankues ka ngritur përmes platformës elektronike e-prokurim dokumente si në vijim:

Grupi i OE ankues "Vlera" Sh.p.k. në platformën elektronike e-prokurim, ka paraqitur listën e stafit me një ekip prej 14 anëtar – ekspert (në këtë listë mungon data), bashkangjitur janë diplomat, CV, Kontratat, (mirëpo për z. EkremSogojeva - Mjek Specialist i Epidemiologjisë– ka sjelle: Certifikatë nr.210 date 08.07.1987, Enti Krahinore për Mbrojtjen Shëndetësore – Prishtinë, Kontrata, por i mungon CV-ja), listën e kontratave në tri vitet e fundit nga njoftimi për kontratë në vlerë totale: 30,927.95 €, ndërsa OE "EkoDezDoo" ka paraqitur një Listë të Stafit me një ekipi prej 20 ekspert të licencuar DDD, Vërtetim nga Instituti i Epidemiologjisë në Akademinë Ushtarake, sektori për spitalet parandalues (në këtë listë mungon data, mungon diplomat dhe CV), listën e kontratave të realizuar në tri vitet e fundit me numër rendor 10 kontrata të përfunduar në vlerë rreth: 344,399.00 €, (kontratat dhe referencat janë në gjuhën serbe dhe janë në valutën Dinarë), Gjithashtu, Grupi i OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit në paramasën – përshkrimin

e çmimeve ka ofertuar me çmimin për njësi me TVSH prej: 0.037 €. Prandaj, duke u bazuar nga të gjitha këto dokumente konsideroj se është e pandershme nga ana e komisionit të vlerësimit ashtu edhe nga departamenti i prokurimit tek Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të jap ARSYTIM ti shkruaj operatorit ekonomik se nuk keni plotësuar kërkesën 1 (nuk keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale duke shkruar komplet kërkesën dhe dëshmitë nga FTD-ja – pa dhënë një sqarim konkret dhe bindës duke arsyetuar përmes bazës ligjore), kurse në VENDIMIN të datës 06.06.2019 të kërkesës për rishqyrtim, ZPP tek arsyetimi po citoj: “OE është i papërgjegjshëm sa i përket dokumentacionit të ofruar për me tepër gjatë ekzaminimit të ofertës së tij me rastin e rishqyrtimit të kësaj kërkesë kemi hasur në një lëshim tjetër të bërë nga OE në Konsorcium, ai ka shkelur nenin 18.3 të Rregullores së udhëzuesit të prokurimit publik” andaj bazuar nga i gjithë ky sqarim, konsideroj se në këtë aktivitet i prokurimit nuk janë respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu, duke marrë për bazë kërkesën nga AK nenin 9.1 & 9.2 të FDT-se, po citoj: Kërkesa: OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: - Një (1) epidemiolog të diplomuar - Një(1) teknik sanitar; Dëshmia: Duhet dorëzuar si dëshmi: kopjet e diplomave, CV dhe kontrata e punës (marrëveshja për angazhim).

Kërkesa: 1. OE-ik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në 36 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej 50,000 euro.

Dëshmia 1: Lista e projekteve të realizuara të dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave të pranimeve në 3 vitet e fundit duke saktësuar - punët e përfshira, - shumën e kontratës, - datën dhe pranuesin

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional lidhur me këtë pretendim konstaton se AK – komisioni i rivlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 39 të RrUOPP-së. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të kërkojë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Prishtinë,–Prishtinë,
- 1x1 OE–“Vlera”SH.P.K.
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.